



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA PUKË  
KËSHILLI BASHKIAK



Nr. 447/3 prot.

Pukë, më 25.03.2026

VENDIM

Nr. 13 datë 25.03.2026

‘PËR DHËNIEN E TITULLIT ‘QYTETAR NDERI’ I BASHKISË PUKË  
Z. GJON BERISHA’

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 ‘Për Vetëqeverisjen vendore’, i ndryshuar, neni 9, pika 1.7, neni 54, germa ‘m’; ligjit nr. 94/2022 ‘Për Titujt e Nderit dhe Titujt Vendor të Nderit në Republikën e Shqipërisë’, VKM nr.861 datë 10.12.2014 ‘Për miratimin e rregullave të hollësishme për funksionimin e komisioneve për dhenien e medaljeve dhe titujve vendorë të nderit në Republikën e Shqipërisë’, VKB nr.71, datë 27.12.2024 ‘Për miratimin e rregullores së Komisionit Këshillimor ‘Për titujt vendor të nderit, kriteret dhe procedurën e dhënies së tyre si dhe emërtimin e rrugëve, shesheve, territoreve, institucioneve dhe objekteve në juridiksionin e Bashkisë Pukë’, me propozim të kryetarit të Bashkisë Pukë, si dhe pas miratimit të Komisionit Këshillimor për Medaljet dhe Titujve Vendor të Nderit në Bashkinë Pukë, Keshilli i Bashkisë Pukë, në mbledhjen e tij me date 25.03.2026, pas shqyrtimit;

VENDOSI:

1. T’i akordojë titullin ‘QYTETAR NDERI’ i Bashkisë Pukë.

Z. GJON BERISHA

Me motivacionin:

‘Për kontributin e shquar humanitar dhe kombëtar në mbështetje të çështjes shqiptare, për ndihmën e vazhdueshme ndaj familjeve në nevojë, arsimit, kulturës dhe institucioneve shoqërore në Shqipëri dhe Kosovë, si dhe për rolin e tij aktiv në mbështetjen e zhvillimeve demokratike dhe përpjekjeve për liri e pavarësi të Kosovës, duke dëshmuar gjithmonë vlerat e solidaritetit, atdhedashurisë dhe fisnikërisë së traditës pukjane.’

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Këshilli i Bashkisë Pukë.

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

4. Vendimi u shpall me date 25.03.2026

Vota të vlefshme gjithsej 11

Vota pro 11, Vota kundër 0, Vota abstenim 0

SEKRETARI

KRYETARI

Hazbi Terbuni

Gjon GJOKA



07.04.26

selc keshillit + S. Jany  
Jany



Keshilli

474/5  
03.04.2026

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
PREFEKTI I QARKUT SHKODER

Nr. 232/1 prot.

Shkodër më 31.03.2026



LËNDA: Mbi vendimet nr. 13/14/15, datë 25.03.2026 të Këshillit të Bashkisë Pukë

**KËSHILLI BASHKIAK PUKË**

Prefekti i Qarkut Shkodër në zbatim të detyrave të tij funksionale të përcaktuara në ligjin nr. 107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, i ndryshua, shkronja “a”, të Urdhërit të Kryeministrit nr. 21, datë 05.02.2025 “Për detyrat e administratës së Prefektit të Qarkut”, të Urdhërit të MB nr. 39, datë 20.02.2025 “Për miratimin e rregullores së brëndshme “Për organizimin dhe funksionimin e Institucionit të Prefektit të Qarkut”, si dhe aneksin I, “Rregullat për procedurat e verifikimit dhe kontrollit nga Prefekti i Qarkut”, të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 54, shkronja “m”, neni 55, pika 2, neni 64, shkronja “c”, ligji nr.94/2022 “Për titujt e nderit dhe titujt vendore të nderit në RSH” neni 9, VKM nr.861 datë 10.12.2014 “Për miratimin e rregullave të hollësishme për funksionimin e komisioneve këshillimore për dhënien e medaljeve dhe titujve vendorë të nderit në Republikën e Shqipërisë”, të shkresës së Këshillit Bashkiak Pukë nr. 466/4 prot., datë 26.03.20256 “Dërgojmë vendimet e Këshillit Bashkiak Pukë të datës 25.03.2026”, u njoh me VKB nr. 13 datë 25.03.3026 “Dhënie titulli qytetar nderi i Bashkisë Pukë për z. Gjon Berisha”, VKB nr.14 datë 25.03.3026 “Dhënie titulli qytetar nderi i Bashkisë Pukë për Kadri Morina”, VKB nr.15 , datë 25.03.2026 “Dhënie titulli qytetar nderi i Bashkisë Pukë për Imam Adem Ademi (pas vdekjes)”.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,



**PREFEKTI**

**Holta DUDA**